

	POLITIKA E SIGURISË DHE SHËNDETIT NË PUNË	PO-SSHM-004
	<i>ver. 3.0</i>	<i>faqe 1 nga 1</i>
<i>Departamenti: Burimet Njerëzore</i>		<i>Sektori: Siguria, Shëndeti në punë dhe Mjedisi</i>

OPERATOR SISTEMI TRANSMISIONI DHE TREGU KOSTT sh.a
 TRANSMISSION SYSTEM AND MARKET OPERATOR KOSTT J.S.C
 OPERATOR SISTEMA PRENOSA I TRZIŠTA KOSTT d.d

POLITIKA E SIGURISË DHE SHËNDETIT NË PUNË

Nr. 1558 Dt. 14 08 2023
 PRISHTINË-A

KOSTT sh.a, është Operator i Sistemit, Transmisionit dhe Tregut të energjisë elektrike në Republikën e Kosovës. KOSTT është përgjegjës për planifikimin, zhvillimin, mirëmbajtjen dhe funksionimin e sistemit të transmisionit të energjisë elektrike në vend.

KOSTT sh.a. ofron mjedis të sigurtë dhe të shëndetshëm për të gjithë punonjësit, kontraktorët dhe vizitorët të cilët përdorin hapësirat dhe pajisjet e KOSTT me qëllim të parandalimit të lëndimeve dhe ruajtjes së shëndetit. Menaxhmenti është i përkushtuar që këtë ta arrijë pajtueshmëri me kërkesat ligjore në fuqi si dhe duke i zbatuar kërkesat e Sistemit të Menaxhimit të Sigurisë dhe Shëndetit në Punë sipas ISO 45001:2018.

Menaxhmenti i KOSTT është i përkushtuar që në vazhdimësi të zbatojë, mirëmbajë dhe përmirësojë sigurinë dhe shëndetin e punonjësve nëpërmjet:

- Definimi dhe zbatimi i rregullave në fushën e sigurisë në punë të krijuara në përputhje me kërkesat ligjore, aktet rregullative duke konsideruar natyrën e veprimtarisë të KOSTT,
- Gatishmërisë për sigurimin e kushteve dhe mjedisit për parandalimin e lëndimeve në punë, sëmundjeve profesionale dhe sëmundjeve tjera të ndërlidhura me punën,
- Identifikimit dhe evitimit të rreziqeve të cilat në kushte të caktuara mund të shkaktojnë lëndime apo dëmtim të shëndetit,
- Nxitjes së zbatimit të rregullave dhe masave praktike nga ana e punonjësve,
- Aftësisimit dhe trajnimit të vazhdueshëm të punonjësve duke përfshirë aftësimin e nevojshëm profesional, si dhe
- Motivimit të personelit të cilët në çfarëdo mënyre janë të kyçur apo përgjegjës në arritjen e objektivave të sigurisë dhe shëndetit në punë.

Politika e Sigurisë dhe Shëndetit në punë do të jetë orientim bazë i KOSTT-it për vendosjen dhe arritjen e objektivave të sigurisë dhe shëndetit në punë.

Kjo politikë do t'i komunikohet të gjithë punonjësve dhe palëve tjera të interesit të KOSTT dhe do të rishikohet vazhdimisht me qëllim të zbatimit të përshtatshëm dhe në harmoni me zhvillimet aktuale.

Data: 14.08.2023

Kryeshefi Ekzekutiv
 Evetar Zediri

